



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment And Spatial Planning

LEJA MJEDISORE E INTEGRUAR

NewCo Ferronikeli Complex L.L.C
FABRIKA PËR PRODHIMIN E Ferro-Nikelit

Glogoc
Republika e Kosovës

Përmbajtja

PARATHËNIE.....	3
LEJA MJEDISORE E INTEGRUAR.....	7
VENDIM.....	Error! Bookmark not defined.
për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar.....	Error! Bookmark not defined.
1. KUSHTET E PUNËS SË IMPIANTIT	8
2. ÇËSHTJET OPERACIONALE	9
2.1. Kontrolli dhe Teknikat e Menaxhimit	9
2.2 Lëndët e para dhe lëndët ndihmëse (Aditivët).....	Error! Bookmark not defined.
2.3. Shfrytëzimi dhe eficientia e energjisë	Error! Bookmark not defined.
2.4 Gatishmëria Emergjente	Error! Bookmark not defined.
2.5 Dekomisionimi dhe rehabilitimi	Error! Bookmark not defined.
3. ÇËSHTJET MJEDISORE.....	Error! Bookmark not defined.
3.1 . ATMOSFERA	Error! Bookmark not defined.
3.1.1 Shkarkimet në ajër (emisionet)	Error! Bookmark not defined.
3.2 UJËRAT	Error! Bookmark not defined.
3.2.1. Konsumi i ujërave	17
3.2.2. Shkarkimet në ujëra	Error! Bookmark not defined.
3.2.3. Mbrojta e ujërave nëntokësor.....	Error! Bookmark not defined.
3.3 MBETURINAT	21
3.3.1. Prodhimi, magazinimi dhe menaxhimi	21
3.4 ZHURMA	Error! Bookmark not defined.
4. PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT	Error! Bookmark not defined.
5. DISPOZITAT TJERA.....	27
5.1. EVIDENCA	27
5.2. RAPORTIMI DHE NJOFTIMET	27
5.3 VLEFESHMËRIA DHE DISPOZITAT PËR NDRYSHIM.....	30
PËRFUNDIMI	30
ARSYESHMËRIA.....	Error! Bookmark not defined.
PLANI PËR VETËMONITORIM.....	Error! Bookmark not defined.

DRAFTI FINAL I LEJES MJEDISORE TE INTEGRUAR

PARATHËNIE

Leja Mjedisore e Integruar është lëshuar sipas Ligjit Nr. 03/L-043 mbi Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, për vënien në funksion të një impianti, në këtë rast Fabrika NewCo FERRONIKELI Complex L.L.C, ku kryhen aktivitetet e renditura në Shtojcën 1 të këtij Ligji, deri në atë masë sa e autorizon Leja.

Leja i përfshinë kushtet të cilat duhet të respektohen.

Një përshkrim i shkurtër i impianti, operimi i të cilit rregullohet përmes kësaj Leje

Fabrika NewCo Ferronikeli Complex L.L.C e cila merret me prodhimin e Fero-Nikelit gjendet në Glllogoc, në rrugën e Feronikelit, pn. dhe numër të regjistrimit të biznesit 70268073, Numri i Çertifikatës UL-70315052-00167 në zonën kadastrale Çikatov e Re e vërtetuar nga Drejtoria për Kadaster, Gjeodezi dhe Pronë e Komunes së Glllogocit e cila është kompani private.

Procesi teknologjik i prodhimit të Ferrinikelit

Procesi teknologjik i FERRONIKELIT e rifillon rrjedhën duke ekspluatuar minierat sipërfaqësore. Gjatë punës së fabrikës, nevojat për xehe mbulohen nga:

- Xehet lokale nga 2 minierat tona të hapura (Çikatova- 1 km larg fabrikës në lindje dhe Gllavica - 13 km larg fabrikës në jug).
- Xehet nga jashtë (Shqipëria, Indonezia, Filipinet, Turqia, Guatemala (minierë e Cunicoresources që e zotëron edhe Ferronikelin) si dhe në të ardhmen xehe nga Afrika.

Pas mihjes në minierë, dhe sjelljes së xehes në fabrikë (lokale apo asaj nga jashtë) procesi teknologjik i FERRONIKELIT është:

- Pas **bluarjes** në madhësi 0-50 mm, xehja dërgohet në shtregën për xehe. Nga shtrega xehja dërgohet në bunkerët furnizues dhe bashkë me linjit në shiritat transportues (dy shirita për xehe, një shirit për linjit). Tharësja ka qenë ma tepër si test, puna me të është ndërprerë që nga 2012 dhe nuk do përdoret më në Ferronikel. Xehja dhe linjiti pastaj furnizohen në furrën rrotulluese; (Tharësja aktuale ka qenë ma tepër si test, puna me të është ndërprerë që nga 2012 dhe e njëjta nuk do përdoret më në Ferronikel) Ekziston mundësia që në të ardhmen të ndërtohet një e re.
- **Tharja dhe pjekja** e xehes bëhet në furrat rrotulluese (dy furra rrotulluese, 100m të gjata, me diametër 5 m). Ngrohja e furrave rrotulluese bëhet me përdorimin e mazutit si lëndë djegëse si dhe petkoksit;
- Xehja e pjekur lëshohet apo hudhet në një kazan dhe përmes vinçave në lartësi bartet në furrën elektrike;
- Gazrat dhe pluhuri që dalin nga furrat rrotulluese trajtohen në precipitatorët elektrostatik.
- **Shkrirja** bëhet në furrën elektrike (teknologjia ELKEM), në temperaturë prej 1400-1600 °C. Shkrirja krijon skorien nga furra elektrike e cila para se të dërgohet në deponinë e skories kthehet në formë granulash. Deponia e skories ndodhet rreth 500m në lindje të fabrikës nga rrethoja e saj. Ekzistojnë dy furra shkrirëse elektrike. Trajtimi i gazrave dhe pluhurit bëhet në skrubërë me ujë.;

- **Rafinimi** i ferronikelit si lëndë e parë (13-16% Ni) bëhet në konvertor vertikal (dy konvertorë), duke fryrë oksigjen dhe shtimin e gurit gëlqeror apo gëlqeres. Rafinimi krijon skorien e konvertorit e cila dërgohet në impiantin magnetik për ndarje (tash një thërmues mobil) e që ndodhet në largësi prej 250 m. Gazrat që lirohen (dalin) trajtohen në skruher me ujë (pajisje pastruese me ujë);
- **Ndarja** e ferronikelit të rafinuar në 25kg ingotë (kallëp). dhe në formë granulash. Prej Tetorit 2013 përdoret mundësia e dytë – ferronikeli i rafinuar në formë granulash për arsye komerciale..

Energjia elektrike: Linja e tensionit të lartë 220 kV furnizon nënstationin kryesor elektrik përmes dy linjave 220 kV në zonën e fabrikës nga termocentrali Kosova B, rreth 20km nga fabrika. Nevojat vjetore të fabrikës për energji elektrike janë rreth 60 MWh për 1 ton të nikelit.

Lejet e tjera valide që i takojnë këtij impianti:

Mbajtësi i Lejes	Numri i Lejes	Data e lëshimit
Pëlqimi Mjedisor, për shkritoren e NewCo Ferronikeli Complex LLC, Drenas	Nr. 07/1403/1-ZSP-1488	13.07.2007
Pëlqimi Mjedisor për stacionin për prodhimin e Oksigjenit	Nr. 09/2084/1-ZSP/10	11.01.2010
Pëlqimi Mjedisor për deponinë e skories në Sukë	Nr.10/2591/1-ZSP-106/11	04.05.2011

Lejet apo autorizimet e tjera që i takojnë këtij impianti, të cilat shfuqizohen me këtë Leje:

Mbajtësi	Numri i Lejes	Data e lëshimit
NewCo Ferronikeli Complex L.L.C ka plotësuar aplikacionin për shkarkimin e ujërave të zeza, por ende nuk është pajisur me leje.		

Konfidencialiteti

Leja Mjedisore e Integruar kërkon që Operatori të dorëzojë informacionin përkatës tek Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. e fut këtë informacion në regjistrat publik në pajtim me kërkesat e Ligjit për PKIN. Nëse Operatori e konsideron ndonjërin prej informacioneve si konfidencial, në aspektin komercial apo industrial,

atëherë mund të aplikojë te Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. që kjo e fundit ta mbajë këtë informacioni të fshehtë, duke mos e futur atë në regjistrat publik, në pajtim me Ligjin për PKIN.

Në mënyrë që Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. të jetë në gjendje të vendosë nëse informacioni është konfidencial në aspektin komercial, Operatori duhet ta identifikojë qartë informacionin në fjalë dhe duhet t'i specifikojë qartë dhe saktë arsyet pse ai informacion konsiderohet konfidencial. Operatori mund të specifikojë se cilat dokumente apo pjesë të dokumentacionit i konsideron si konfidenciale, në aspektin komercial dhe industrial. Operatori duhet t'i theksojë argumentet pse informacionet përkatëse duhet të shpallen konfidenciale nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Informacioni në fjalë dhe argumentimi për konfidencialitetin e tyre duhet të dorëzohen bashkë me lejen mjedisore të integruar në një zarf të posaçëm.

Ndryshimi i Lejes Mjedisore të Integruar

Leja Mjedisore e Integruar mund të ndryshohet në pajtim me Ligjin për PKIN.

Dorëzimi i Lejes Mjedisore të Integruar

Operatori do ta njoftoi Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për synimin e tij për përfundimin e pjesërishëm apo të plotë të aktiviteteve të impiantit. Që aplikuesi të jetë i suksesshëm në synimin e tij, ai duhet të jetë në gjendje t'i dëshmojë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor se nuk ka rrezik për ndotje.

Transferimi i Lejes Mjedisore të Integruar

Përpara se Leja Mjedisore e Integruar të transferohet tek një person tjetër, duhet të bëhet një aplikim nga të dyja palët, për transferimin e Lejes Mjedisore të Integruar në pajtim me Nenin 15 të Ligjit për PKIN.

Nëse Leja Mjedisore e Integruar autorizon kryerjen e një aktiviteti specifik të administrimit të mbeturinave, atëherë duhet të dorëzohet Leja Mjedisore e Integruar, certifikata për administrimin e mbeturinave për personin që është përgjegjës për aktivitetin e tillë.

Regjistri i Gjendjes (status log)

Detajet	Data	Komentet
Aplikacionit për Leje Mjedisore të Integruar dhe sipas kërkesës së operatorit NewCo Ferronikeli Complex L.L.C Nr.Protokolit 593/12	09.03.2012	
Kërkesa për informata shitesë nga Dokumentacioni për Leje Mjedisore të Integruar Nr.Protokolit 593/12	12.04.2012	
Dokumentacioni shitesë për	04.05.2012	

Leje Mjedisore të Integruar Nr. Protokoli 2828		
Kërkesa për informata shitesë nga Dokumentacioni shitesë për Leje Mjedisore të Integruar Nr.Protokolit 2828	25.06.2012	
Dokumentacioni shitesë për Leje Mjedisore të Integruar Nr.Protokolit 3052/12	01.11.2012	
Kërkesa per informata shitesë nga Dokumentacioni shitesë për Leje Mjedisore të Integruar Nr.Protokolit 3052/12	20.11.2012	
Dokumentacioni shitesë për Leje Mjedisore të Integruar	27.11.2012	

LEJA MJEDISORE E INTEGRUAR

Leja numër 2.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Duke u bazuar në Nenin 30 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03L/-25, Ligji Për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes Nr.03/L-043, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.03/2011 për Formën, Përmbajtjen dhe Mënyrën e Plotësimit të Aplikacionit për Leje të Integruar dhe sipas kërkesës së operatorit NewCo Ferronikeli Complex L.L.C me Nr. Protokolit 593/12 të datës 09.03.2012 e cila gjendet në Glllogoc, në rrugën e Feronikelit, p.n, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor merr:

VENDIM

Për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar

Operatorit: NewCo Ferronikeli Complex L.L.C

Adresa : Rruga e Ferronikelit, p.n.

Kodi Postar Qyteti : 13000 Glllogoc

Shteti : Republika e Kosovës

Numri i Regjistrimit të Kompanisë: 70268073

Zona Kadastrale: Çikatovë e Re

Numri i zones kadastrale: 70315052

Numri i Çertifikatës: UL-70315052-00167

Për operimin e Impiantit në: Glllogoc

Emri i plotë i impiantit: NewCo Ferronikeli Complex L.L.C

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor: Arben Çitaku

Nënshkrimi:

Datë:


1. KUSHTET E PUNËS SË IMPIANTIT

1.1. Operatori është i autorizuar të kryejë aktivitetet dhe/ose aktivitetet shoqëruese të specifikuara në Tabelën 1.1

Tabela 1.1.

Aktiviteti në kuadër të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 03/L-043 për “Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes”	Përshkrimi i aktivitetit specifik	Kufijtë e aktivitetit specifik
Prodhimi dhe përpunimi i metaleve	Impiantet për shkrirje të metaleve,përfshirë vendosjen në kallëpe,të metaleve jo-ferrore përfshirë prodhimet e ripërpunuara ,(rafinimin,derdhjen e metaleve të shkrira etj.) me një kapacitet shkrirës që tejkalon katër (4) ton në ditë për plumbin dhe kadmiumin,ose njëzet (20) ton në ditë për të gjith metalet tjera.	Prodhimi i Fero-Nikelit me një kapacitet prodhues 40 t Ni /ditë

1.2 Aktivitetet e autorizuar sipas tabelës 1.1. nuk duhet të shtrihen përtej Vendit, që paraqet zonën e përkufizuar sipas planit të mëposhtëm



--> plani i implantit, ashtu siç është paraqitur në formën e aplikacionit

1.3 Impianti nuk duhet të futet në funksion përderisa nuk përmbushen procedurat e mëposhtme dhe përderisa nuk njoftohet me shkrim Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor.

2. ÇËSHTJET OPERACIONALE

2.1. Kontrolli dhe Teknikat e Menaxhimit

2.1.1. Impianti, duke iu nënshtuar kushteve të Lejes Mjedisore të Integruar, duhet të menaxhohet dhe kontrollohet siç përshkruhet në dokumentacionin e specifikuar në Tabelën 2.1.1, apo siç është rënë dakord me shkrim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

2.1.2. Të gjithë implantet, pajisjet dhe mjetet teknike që përdoren për operimin e Impiantit duhet të mbahen në gjendje të mirë funksionale.

2.1.3. Impianti duhet të mbikëqyret nga një person i aftësuar, dhe që është plotësisht i familjarizuar me kushtet e Lejes Mjedisore të Integruar.

2.1.4 Një kopje e Leje Mjedisore të Integruar , duhet që të jenë në dispozicion në çdo kohë për punëtorët që janë të angazhuar në këtë drejtim, në pajtim me kushtet e Lejes Mjedisore të Integruar.

2.1.5 Të gjithë punëtorët duhet të njoftohen plotësisht me kushtet e Lejes, të cilat ndërlidhen me detyrat e tyre. Punëtorët duhet të aftësohen/ trajnohen dhe duhet t'iu sigurohen, në formë të shkruar udhëzimet për operim, në mënyrë që të jenë të aftë t'i kryejnë detyrat e tyre.

2.2 Lëndët e Para dhe lëndët ndihmëse (Aditivët)

2.2.1. Operatori duhet t'i shfrytëzojë lëndët e para dhe lëndët ndihmëse të përshkruara në Tabelën 2.

Tabela 2.2.1

Të dhënat për artikullin përkatës	Kushti specifik	Dokumentacioni përkatës
Xehja, linjiti+petkoksi+gëlqerja, mazuti, qymyrguri i Indonezisë, dolomiti, oksigjeni(lëng+gaz)+biomasa	Rezervuarët e mazutit të kontrollohen, mirëmbahen dhe të sigurohen me murin mbrojtës prej betoni për të penguar rrjedhjen e pa kontrolluar të mazutit.	Plani i mirëmbajtjes
	Detyrohet Operatori ti merr të gjitha masat për shfrytëzimin efikas të lëndëve të para dhe lëndët ndihmëse në të gjitha pjesët e procesit, duke marrë në konsideratë zvogëlimin e gjenerimit të mbeturinave dhe praktikatat më të mira për këtë lloj të aktivitetit.	Regjistrimi
	Ngarkimi dhe shkarkimi, si dhe deponimi i materialit të bëhet në vende të caktuara duke marrë masat e nevojshme që mos të vjen deri tek rrjedhja e tyre.	Plani i intervenimit në rast të aksidenti mjedisor
Materiali zjarrdurues	Operatori duhet të kontrollojë sasinë e materialeve zjarrduruese që përdoren në furrën rrotulluese furrën elektrike si dhe në konventor konsumimi vjetor duhet të jetë i regjistruar.	Regjistrimi

2.2.2. Substancat e rrezikshme duhet të etiketohen sipas Rregullores (EC) Nr 1272/2008. Etiketat me të dhëna mbi sigurinë e produktit duhet të jenë të pranishme dhe të jenë të azhurnuara; ruajtja e substancave të rrezikshme duhet të bëhet në kontejner dhe hapësira të përshtatshme, duke e marrë parasysh pajtueshmërinë kimike.

2.3 Shfrytëzimi dhe Eficienca e Energjisë

2.3.1. Operatori duhet, në pajtim me kushtet e kësaj Leje, të shfrytëzojë energjinë siç përshkruhet në Tabelën 2.3.1

Tabela 2.3.1.

Burimi i energjisë apo konsumi specifik i saj	Kushti specifik	Dokumentacioni përkatës
Linjiti e Kosovës në furrën rrotulluese.	Të merren masat parandaluese që të mos vjen te vetëndezja e lignitit.	Dokumenti teknik
Qymyrguri i Indonezisë në furrën rrotulluese Koksi në furrën elektrike Petkoksi në furrën rrotulluese Linjiti i Maqedonisë në furrën rrotulluese.		
Mazuti në furrën rrotulluese, ngrohtore.	Rezervuarët e mazutit të kontrollohen, mirëmbahen dhe të sigurohen me murin mbrojtës prej betoni për të penguar rrjedhjen e pa kontrolluar të mazutit.	
Masë elektroda (lëndë djegëse e ngurtë) në furrën elektrike		
Energjia elektrike në dy furrat elektrike rreth 86% ndërsa 14% harxhohet në lokacionet tjera.	Me qellim të përputhjes me TMM, operatori, në kuptimin e zvogëlimit të shfrytëzimit të energjisë elektrike, duhet të bëjë zëvendësimin e energjisë elektrike me një formë tjetër të energjisë kudo që të jetë e mundur. Operatori duhet ta përdor në mënyre efikase energjinë në të gjitha proceset e prodhimit aty ku është e mundur.	

2.3.2. Kërkohet nga operatori që të bëjë një studim të fizibilitetit për shfrytëzimin e burive alternative të energjisë.

2.3.3. Operatori duhet të përdori vetëm ato lëndë djegëse alternative sipas lejes së veçantë dhe licencave të lëshuara nga Ministria e Mjedisit, pas ratifikimit të studimit të fizibilitetit.

2.4 Gatishmëria Emergjente

2.4.1 Në pajtim me kushtet e kësaj Leje, Operatori duhet, t'i parandalojë dhe kufizojë pasojat nga aksidentet, siç përshkruhet në dokumentacionin e specifikuar në Tabelën 2.4.1

Tabela 2.4.1.

Ndodhitë apo mjetet potencialisht të dëmshme	Kushti specifik	Dokumentacioni përkatës
Rrjedhja e mazutit në stacionin e pompave/rezervuarët kryesor	Ndërtimi i basenit prej betonit-muri mbrojtës dhe mirëmbajtja e rregullt	Dokument teknik
Mbi rrjedhja e mazutit nga rezervuari ditorë me rrjedhje në tokë dhe pastaj përmes drenazhit arrin ujin në efluent	Ndërtimi i basenit nga betoni, ndarës i vajit para pikës së emisionit të ujit efluent	Dokument teknik
Shkarkimi i kemikateve (aditivët për trajtimin e ujit, acidet, bazat)	Praktikë e mirë e ruajtjes, zëvendësimi me aditiv të cilët nuk janë të rrezikshëm për Mjedisin	
Shkarkimi aksidental i ujit ftohës nga kullat ftohëse e cila mund të vjen nga mos funksionimi i pompës për ujë	Rritja e kapacitetit mbajtës në kullat ftohëse, mirëmbajtja e rregullt e pompës.	Raport i mirëmbajtjes
Rrjedhja e vajrave të përdorura	Vajrat e përdorura të ruhen në fuçi metalike, të jen të siguruara mirë.	Dokument teknik
Eksplodimi në precipitatorët elektrostatik (furra rrotulluese) kjo mund të vjen nëse përqindja e CO është e lartë në filtër , ekziston rreziku nga eksplodimi (elektrodat emituese)	Kontrollimi i përqindjes së CO, para se të hyj në filtër (PES).	Dokument teknik
Për shkak të temperaturës së lartë, të përfshirë në proces.	Fillimi apo ndalja e punës të bëhet në mënyrë graduale	Raport teknik

2.5 Dekomisionimi dhe Rehabilitimi

2.5.1. Me kushtet e përcaktuara në këtë Leje, Operatori, pas ndërprerjes përfundimtare të funksionimit të impiantit, duhet të i planifikoi masat për dekomisionimin e Impiantit dhe për rehabilitimin e vendndodhjes së tij.

3. ÇËSHTJET MJEDISORE.

3.1 . ATMOSFERA

3.1.1 Shkarkimet në ajër (emisionet)

3.1.2. Burimet e shkarkimeve në ajër janë të paraqitura në Tabelën 3.1.2.

Tabela 3.1.2

Pikat e shkarkimeve (emisioneve) në ajër	Fazat e prodhimit	Sistemi i pastrimit	Karakteristikat e pikës së emisionit
A2.1	Furrat rrotulluese	ESP	$F= 220000 \text{ N m}^3/\text{h};$ $T= 170^\circ; h=100\text{m}$
A2.3	Furra elektrike 1	Skruberi me ujë	$F= 6.027,84 \text{ Nm}^3/\text{h}$ $T= 33.70^\circ\text{C}, h=55\text{m}$
A2.4	Furra elektrike 2	Skruberi me ujë	$F= 5.559,84 \text{ Nm}^3/\text{h}$ $T= 33.40^\circ\text{C} h=55\text{m}$
A2.2	Konvertori	Skruberi me ujë	$F= 119.559,20 \text{ Nm}^3/\text{h}$ $T= 41.10^\circ\text{C} h=50\text{m}$
A1.1	Ngrohtorja	Nuk ka trajtim	$F= 19000 \text{ Nm}^3/\text{h};$ $T= 240^\circ\text{C}; h=12\text{m}$

F- Rrjedhja vëllimore e gazit (m^3/h)

T- Temperatura e gazrave të emituara ($^\circ\text{C}$)

h- Lartësia e oxhakut (m)

3.1.3. Nuk duhet të tejkalohen limitet për emisionet në ajër, për substancat dhe pikat e emisionit në ajër të specifikuar në Tabelën 3.1.3

Tabela 3.1.3.

Pikat e shkarkimeve (emisioneve) në ajër	Substancat	Vlera Kufitare e Emisionit (VKE)	Njësia matëse	Shpeshtësia
A2.1	Pluhuri	50	mg/Nm^3	Kontinuale
	SO_2	800	mg/Nm^3	Kontinuale
	NO_x	400	mg/Nm^3	Kontinuale

	Hg+Cd+Ti	0.3	mg/Nm ³	Vjetore
	Pb+Fe+Ni+Cr+Co	0.4	mg/Nm ³	Vjetore
	PCDD/DF	0.7	ngTEQ/Nm ³	1 here/2 vite
A2.2	Pluhuri	50	mg/Nm ³	Kontinuale
	SO ₂	800	mg/Nm ³	Kontinuale
	NO _x	400	mg/Nm ³	Kontinuale
	Hg+Cd+Ti	0.3	mg/Nm ³	Vjetore
	Pb+Fe+Ni+Cr+Co	0.4	mg/Nm ³	Vjetore
	PCDD/DF	0.7	ngTEQ/Nm ³	1 here/2 vite
A2.3	Pluhuri	50	mg/Nm ³	Kontinuale
A2.4	Pluhuri	50	mg/Nm ³	Kontinuale
A1.1	Pluhuri	100	mg/Nm ³	Periodike
	SO ₂	1700	mg/Nm ³	Periodike
	NO _x	450	mg/Nm ³	Periodike

3.1.4. Operatori duhet ti arrijë Vlerat kufitare të emisioneve në ajër për të gjitha substancat e specifikuar në Tabelën 3.1.4 deri më **31.12.2017**

Tabela 3.1.4

Pikat e shkarkimeve (emisioneve) në ajër	Substancat	Vlera Kufitare Emisionit (VKE)	Njësia matëse	Shpeshtësia
A2.1	Pluhuri	30	mg/Nm ³	Kontinuale
	SO ₂	600	mg/Nm ³	Kontinuale
	NO _x	350	mg/Nm ³	Kontinuale
	Hg+Cd+Ti	0.2	mg/Nm ³	Vjetore
	Pb+Fe+Ni+Cr+Co	0.3	mg/Nm ³	Vjetore
	PCDD/DF	0.6	ngTEQ/Nm ³	1 here/2 vite

A2.2	Pluhuri	30	mg/Nm ³	Kontinuale
	SO ₂	600	mg/Nm ³	Periodike
	NO _x	350	mg/Nm ³	Periodike
	Hg+Cd+Ti	0.2	mg/Nm ³	Vjetore
	Pb+Fe+Ni+Cr+Co	0.3	mg/Nm ³	Vjetore
	PCDD/DF	0.6	ngTEQ/Nm ³	1 here/2 vite
A2.3	Pluhuri	30	mg/Nm ³	Kontinuale
A2.4	Pluhuri	30	mg/Nm ³	Kontinuale
A1.1	Pluhuri	50	mg/Nm ³	Periodike
	SO ₂	900	mg/Nm ³	Periodike
	NO _x	350	mg/Nm ³	Periodike

3.1.5. Operatori duhet ti arrijë Vlerat kufitare të emisioneve në ajër për të gjitha substancat e specifikuar në Tabelën 3.1.5. deri më **31. 12. 2022**

Tabela 3.15.

Pikat shkarkimeve (emisioneve) në ajër	Substancat	Vlera Kufitare Emisionit (VKE)	Njësia matëse	Shpeshtësia
A2.1	Pluhuri	20	mg/Nm ³	Kontinuale
	SO ₂	500	mg/Nm ³	Kontinuale
	NO _x	300	mg/Nm ³	Kontinuale
	Hg+Cd+Ti	0.1	mg/Nm ³	Vjetore
	Pb+Fe+Ni+Cr+Co	0.2	mg/Nm ³	Vjetore
	PCDD/DF	0.5	ngTEQ/Nm ³	1 here/2 vite
A2.2	Pluhuri	20	mg/Nm ³	Kontinuale
	SO ₂	500	mg/Nm ³	Kontinuale
	NO _x	300	mg/Nm ³	Kontinuale
	Hg+Cd+Ti	0.1	mg/Nm ³	Vjetore
	Pb+Fe+Ni+Cr+Co	0.2	mg/Nm ³	Vjetore
	PCDD/DF	0.5	ngTEQ/Nm ³	1 here/2 vite
A2.3	Pluhuri	20	mg/Nm ³	Kontinuale

A2.4	Pluhuri	20	mg/Nm ³	Kontinuale
A1.1	Pluhuri	20	mg/Nm ³	Periodike
	SO ₂	700	mg/Nm ³	Periodike
	NO _x	300	mg/Nm ³	Periodike

Nivelet e lejuara të materieve ndotëse në ajër, janë përcaktuar duke u bazuar ne nivelet të emisioneve ne ajër sipas U.A .Nr 06/2007,BREF dokumentit duke përdor TMM.

3.1.6. Operatori duhet të bëj monitorimin e substancave të paraqitura në tabelat e Shtojcës 1.

3.1.7. Në pajtim me kushtet e kësaj Leje, Impianti duhet të operoi në mënyrën e përshkruar në dokumentacionin e specifikuar në Tabelën 3.1.7. si dhe duke i përdorur teknikat që përshkruhen në po këtë dokumentacion:

Tabela 3.1.7.

Të dhënat për artikullin përkatës	Kushti specifik	Dokumenti përkatës
Emisionet e CO ₂	Operatori duhet ti përdor TMM, sipas BREF dokumentit, për ti minimizuar emisionet e CO ₂ në ajër	Raport teknik
Emisionet e CO	Operatori duhet ti përdor TMM, sipas BREF dokumentit, për ti minimizuar emisionet në ajër nga CO	Raport teknik
Furra elektrike Oxhaku emergjent	Operatori duhet të minimizoj numrin e hapjeve të oxhakut emergjent, të furrës elektrike.	Grafiku i temperaturës në oxhakun emergjent;
	Operatori duhet të mbaj një regjistër për numrin e hapjes së oxhakut emergjent.	Libri i punës
Ngrohtorja	Operatori duhet të përdor ngrohtoren vetëm nëse puna e flakëdhësit bëhet sipas udhëzimeve të prodhuesit.	Raport teknik
Furra rrotulluese- Sistemi kontinual i monitorimit të emisioneve	Operatori duhet të mbajnë një regjistër për kalibrimin e zakonshëm, mirëmbajtjen dhe mosfunksionimin e sistemi. Kalibrimi duhet të bëhet duke u bazuar në ISO14181 2005 Operatori duhet të ndërmer masat, nëse sistemi nuk është duke punuar për një periudhë më të gjatë se 3 ditë	Regjistër të sistemit kontinual të monitorimit të emisioneve
Emisionet difuzive	Operatori duhet të bëjë transportimin e xehes me sistem të mbyllur, si dhe të vendos barrierave mbrojtëse nga era, spërkatje e përhershme e sipërfaqes operationale përreth fabrikës dhe rehabilitimin e deponisë së skories pas mbylljes së sajë.	Raport teknik

	Operatori duhet të zbatojë të gjitha masat e nevojshme për të shmangur shpërndarjen e emisionit të pluhurit në atmosferë, sidomos nga magazinimi i lëndëve të para .	
Cilësia e ajrit	Operatori duhet të bëjë monitorimin e cilësisë së ajrit përreth fabrikës dhe jashtë fabrikës për grimcat e suspenduara(PM ₁₀ , PM _{2.5}), CO, NO _x , SO ₂ , metalet e rënda (Fe, Ni, Hg, Cr, Co,), të përcjell pozitën dhe frekuencën e përshkruar në Planin e Vetëmonitorimit.	Vendosja e pajisjes për matje automatike të cilësisë së ajrit ambiental ose marrjen e mostrave dhe analiza e tyre.
Mirëmbajtja	Furrat rrotulluese, elektrike dhe konvertorët duhet të jenë subjekt për mirëmbajtje të plotë së paku vjetore; Operatori është i detyruar për të bërë një planë për ndërhyrjen në mirëmbajtje dhe për të regjistruar aktivitetin e bërë.	Dokument teknik
Miniera e eksplotimit të xehes në Çikatovë	Obligohet operatori që ti përdor TMM sipas BREF dokumentit për administrimin e mbetjeve dhe mbeturinës-guri (waste-rocks) nga aktivitetet minerare.	Raport
Deponia e skories në Sukë	Operatori është i detyruar ti plotësojë kushtet e përcaktuara në Pëlqimin Mjedisor dhe zbatimin e të gjitha masave mbrojtëse të përshkruara në Raportin e VNM.	Raport
Emisionet nga Dioksinat	Obligohet operatori që ti përdor TMM sipas BREF dokumentit për ti minimizuar emisionet në ajër nga dioksinat. Pas flakëdhësit temperatura duhet të mbahet mbi 850°C Përdorimi i flakëdhësit dhe pajisja me filtrim të thatë për ti zvogëluar emisionet.	

3.1.8. Të gjitha emisionet nga Impianti duhet të mos kenë erë të pakëndshme jashtë kufijve të Impiantit.

3.1.9. Të gjitha emisionet në ajër, me përjashtim të avullit apo avullit të kondensuar të ujit, duhet të jenë pa pikëza, pa mjegull dhe tym të përherëshëm.

3.1.10. Të gjitha emisionet nuk duhet të përmbajnë tym të dukshëm. Nëse për qëllim mirëmbajtjeje, emisionet e tymit shkaktohen si rezultat i arritjes së pikës së ndezjes nga të ftohtit, kjo nuk duhet të zgjasë më shumë se 20 minuta brenda periudhës kohore prej 8 orësh, si dhe duhet të ndërmerren të gjithë hapat praktik për ta reduktuar emisionin.

3.2 UJËRAT

3.2.1. Konsumi i ujërave

Operatori nuk duhet të tejkalojë limitet e konsumit të ujit të freskët, të specifikuar në tabelën 3.2.1

Tabela 3.2.1

Të dhënat mbi pikën e konsumit (abstraksionit)	Burimi i ujit	Limiti ditor i konsumit (abstraksionit), m3/ditë	Limiti vjetor i konsumit (abstraksionit), m3/vit
Uji për proces të prodhimit	Liqeni i Gazivodes		2400000 (m ³ /vit)
Uji për pije, kuzhinë e sanitari	“KUR” Prishtina		420000 (m ³ /vit)

Sasia e ujit që del nga nyja e xehes dhe të konsumuar duhet të monitorohet dhe të raportohet sipas Shtojcës 1 (Plani i Vetë-Monitorimit).

Me marrjen e Lejes ujore, vlejné kushtet e paraqitura në atë leje.

3.2.2. Shkarkimet në ujëra

Shkarkimet në ujërat sipërfaqësore nga pikat e shkarkimit të specifikuara në Tabelën 3.2.2.1 duhet të burojnë vetëm nga burimi (burimet) e specifikuara

Tabela 3.2.2.1

Të dhënat për shkarkimet	Burimi	Sistemi i trajtimit	Lokacioni i pikës së emisionit
Uji industrial është ujë riqarkullues (nuk shkarkohet)	Uji i freskët për nevoja industriale	Uji riqarkullues	Ftofja e trupit të furres elektrike, granulimi i skories, prodhimi i avullit (ngrohtorja), uji për depluhërimin e konvertorit dhe të FE
Gypi shkarkues i fabrikës (SW2 – në hartë)	Uji i trajtuar sanitar	Impianti për trajtimin e ujërave të zeza	Uji që rrjedh nga kuzhina dhe objektet tjera sanitare
Kanali i hapur nga deponia e Sukës (SW5 – në hartë)	Uji nga të reshurat që rrjedhin nga deponia e skories	Nuk ka trajtim	Deponia e skories
Gypi shkarkues i fabrikes (SW2 – në hartë)	Uji që rrjedh nga fabrika	Në planin e përputhshmërisë (bazeni sedimentues)	Hapësira e fabrikës

Gypi shkarkues i fabrikës (SW2 – në hartë)	Uji nëntokësor	Me pompa dërgohet në gypat e ujit atmosferik (nuk trajtohet)	Nyja e xehes (nën thërmues-objekti 01)
---	----------------	--	--

Nuk duhet të tejkalohen limitet për shkarkimet në ujërat sipërfaqësore për parametrin (parametrat) dhe pikën (pikat) e shkarkimit të specifikuar në Tabelë 3.2.2.2. Nuk duhet të ketë shkarkime të substancave në ujërat sipërfaqësore nga Impianti i Lejuar për të cilat në Tabelën 3.2.2.2 nuk është specifikuar limiti, përveç në rast se përqendrimi i tyre nuk është më i madh se përqendrimi i tyre i mëparshëm në ujërat sipërfaqësore përpara shkarkimit nga Impianti.

Tabela 3.2.2.2.

Pikat e burimit të emisionit	Parametrat	Vlera kufitare e emisionit	Njësitë	Periudha e referimit
Uji industrial	Riqarkullohet	-	-	-
Uji i trajtuar sanitar	- Materiet e fundërruara - Materiet e suspenduara - SHBO₅ (mg/l) - SHKO (mg/l) - Karboni organik total - Temperatura - pH - Ngjyra - Aroma - vajrat dhe yndyrat - bakteriet califorme të përgjithshme (MPN/100ml)	1.0 150 80 400 40 35 6-8.5 dobët dobët 10 6000	ml/lh mg/l mg/l mg/l mg/l gradë celsius mg/l 100 ml	4 / vit
Kanali i hapur nga deponia e Sukës	- Materiet e suspenduara - Fe - Ni - Co - Cr - pH	150 5.0 1.5 1.5 1.75 6-8.5	mg/l mg/l mg/l mg/l mg/l	Mujore

	- Materiet e fundërruara - Materiet e suspenduara - SHBO₅ (mg/l) - SHKO (mg/l) - Karboni organik total - Temperatura - pH - Ngjyra - Aroma - vajrat dhe yndyrat - bakteriet califorme të përgjithshme (MPN/100ml)	1.0 150 80 400 40 35 6-8.5 dobët dobët 10 6000	ml/lh mg/l mg/l mg/l mg/l gradë celsius mg/l 100 ml	4 / vit
Uji nëntokësore (nën thërrmues)	- Fe - Ni - Co - Cr - pH - Temperatura - Ngjyra - Aroma	5.0 1.5 1.5 1.75 6-8.5 35 dobët dobët	mg/l mg/l mg/l mg/l grad celzius	Mujore
Uji sipërfaqësor përreth fabrikës	- Materiet e suspenduara - Fe - Ni - Co - Cr - pH	150 5.0 1.5 1.5 1.75 6-8.5	mg/l mg/l mg/l mg/l mg/l	Mujore

Detyrohet operatori ta kontrollojë dhe riparon sistemin për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave që rrjedhin nga kanali përreth deponisë së skories dhe të bënë trajtimi i këtyre ujërave para se të shkarkohen në lumin Drenica.

Detyrohet operatori që në rast të ndryshimit të cilësisë dhe sasisë së ujit të nxjerrur nga liqeni i Gazivodës dhe shkarkimin në lumin Drenica, menjëherë duhet të kontakton autoritetin përgjegjës për lëshimin e lejeve ujore.

Detyrohet operatori që të sigurojë që testi i cilësisë së ujit dhe ndikimi i tyre në mjedis të merret përmes personave juridik që janë të autorizuar për kryerjen e testeve të tilla.

Operatori lajmëron organin përgjegjës për Mjedis, së paku një herë në vit për matjet e kryera. Nëse vjen deri të shkarkimi i pa kontrolluar i materieve ndotëse në ujë operatori është i detyruar që menjëherë të informojë organin përgjegjës për Mjedis.

Kur specifikohet në Tabelë limiti vjetor i masës për një substancë, shkarkimi total i asaj substance nga Impianti i Lejuar në ujërat sipërfaqësore nga pikat e shkarkimit të specifikuar në 3.2.2.2 dhe nuk duhet ta tejkalojë atë limit në asnjë vit.

Tabela 3.2.2.3

Pikat e emisionit	Receptori (sistemi i ujërave të zeza, trupi ujqor)	Sasia e ujit që shkarkohet m ³ /h
-------------------	---	---

Gypi shkarkues i fabrikës (SW2 – në hartë)-(uji i trajtuar sanitar + uji që rrjedh nga fabrika+ uji nëntokësor)	Trupi uhor (Lumi Drenica)	80 m ³ /h
--	---------------------------	----------------------

3.2.3. Mbrojta e Ujërave Nëntokësore

Impianti i Lejuar duhet, në pajtim me kushtet e kësaj Leje, të kontrollohet siç përshkruhet në Tabelën 3.2.3 apo ashtu siç është rënë dakord me shkrim me Autoritetin Kompetent.

Tabela 3.2.3.

Të dhënat për artikullin përkatës	Kushti specifik	Dokumenti përkatës
Gypi shkarkues i fabrikës (SW2 – në hartë)	Detyrohet operatori ta menaxhojë procesin e punës në atë mënyrë që do të bëjë të mundur që cilësia e ujit të shkarkuar ti plotëson kërkesat për shkarkimin e ujërave të ndotura në lumin Drenica sipas kategorisë V duke u bazuar në U.A.Nr.13/2008 për vlerat kufizuese të efluentit që shkarkohet në trup uhor apo në rrjetin e kanalizimit publik.	Regjistër
Impiantin për pastrimin e ujërave te zeza, gypat e ujërave atmosferike,ujërave të zeza	Detyrohet operatori që impiantin për trajtimin e ujërave të zeza, gypat e ujërave atmosferike,ujërave të zeza të mbaj në gjendje të rregullt Detyrohet operatori që të vendosë pajisjen matëse që matë dhe regjistron sasinë e ujërave të ndotura	Regjistër të pajisjes për trajtimin e ujit.

3.3 MBETURINAT

3.3.1. Prodhimi, magazinimi dhe menaxhimi

Operatori duhet, në pajtim me kushtet e kësaj Leje, të menaxhojë dhe magazinojë mbeturinat siç përshkruhet në Tabelën 3.3.1.

Tabela 3.3.1.

Përshkrimi i mbeturinës sipas Katalogut Evropian të Mbeturinave	Burimi	Lokacioni	Mënyra e ruajtjes	Kushtet e ruajtjes
---	--------	-----------	-------------------	--------------------

01 03 99 - Skoria e FE	Furra elektrike	Deponia e skories në Sukë	Deponohet	Deponohet në deponin e skories.
01 03 99- Skoria e konvertorëve	Konvertori	Deponohet afër seperacionit magnetik	Deponohet / Riciklohet	Riciklohet
10 02 14 - Lymi i skruberit	Trajtimi i gazrave dhe pluhurit në furra elektrike dhe konvertorë, ky lym shkon në fundërruesit radial	Objekti 19 – stacioni i lymit, ku prej aty transportohet në bunkerët furnizues të FRr	Deponim i përkohshëm në stacionin e lymit – objekti 19	Riciklohet
10 02 06- . Material zjarrdurues	Konv+FRr+FE	Deponia për materiale të përkohshme brenda fabrikës	Deponohet	Deponim i përkohshëm
12 01 01 -Metali nga Tornim	Punëtorja qendrore	Deponia për materiale të përkohshme brenda fabrikës	Deponohet në kontejner 4 m ³	Deponim i përkohshëm
12 01 02-Gypat për fryrje	(EF + konvertor (FE+Konvertori)	Deponia për materiale të përkohshme brenda fabrikës	Riciklohet (shitet si skrap metal)	Riciklohet
15 01 04-Bure (fuqi) të dëmtuara(Fabrika +Miniera e Çikatoves)		Deponi për materiale të përkohshme brenda fabrikë	Deponim i përkohshëm	Deponim i përkohshëm
17 04 05-Llamarinë dhe metal tjetër (PQ+Energjetika		Deponi për materiale të përkohshme	Shitet si skrap metal	Deponim i përkohshëm
13 01 07*-Vaji hidraulik((Mirëmbajtja)		Deponia për materiale të rrezikshm (bazeni hapur prej betoni) është caktuar kryesisht për mbetjet e rrezikshme (vaj i përdorur, tank metalike, enë plastike, etj)	Ruhet në bure	Deponim i përkohshëm
13 02 03* -Vaji i përdorur (Mirmb+Transporti i mbrendshëm)		Deponia për materiale të rrezikshme (bazen i hapur prej betoni) është	Ruhen në kontejner plastike 1000 L	Deponim i përkohshëm

		caktuar kryesisht për mbetjet e rrezikshme (vaj i përdorur, tank metalike, enë plastike, etj		
15 01 02-Plastika (FE+Energjetika)		Hudhen nëpër kontejner të mbeturinave	Hudhen	Deponim i përkohshëm
20 01 04-Plastika (Laboratori)		Hudhen nëpër kontejner të mbeturinave	Hudhen	Deponim i përkohshëm
15 01 03- Dru nga paletat (Tr. brendshëm+Transporti i brendshëm)		Deponia për materiale të përkohshme	Deponohen (Zakonisht i`u jepen punëtorëve falas)	Deponim i përkohshëm
15 01 07-Qelqe nga laborator		Hudhen nëpër kontejner	Hudhen	Kompania private i merr këto mbeturina
16 01 03-Shiritat transportues dhe goma(FRr+Obj.Xeh+Min+Tr)		Deponi për materiale të përkohshme	Deponohen	Deponim i hapur
16 06 05*-Akumulatorë (Miniera+Transporti)		Deponi për materiale të rrezikshme (një vend e mbyllur)	Ruhen	Deponim i mbyllur
17 07 03-Mbeturina nga konstruktimi (Punëtorët qendrore)		Deponi për materiale të përkohshme	Shitet (pasi janë pjesë metalike)	Deponim i përkohshëm
20 01 01-Letër (të gjitha departamentet)		Hudhet nëpër kontejner të mbeturinave	Hudhet	Kompania private i merr këto mbeturina
20 03 01-Mbeturinë komunale		Hudhen nëpër kontejner të mbeturinave	Hudhen	Kompania private i merr këto mbeturina

3.3.2. Operatori duhet, në pajtim me kushtet e kësaj Leje, të ripërdorë dhe deponojë mbeturinat siç përshkruhet në Tabelën 3.3.2, apo ashtu siç është rënë dakord me shkrim me Autoritetin Kompetent.

Tabela 3.3.2

Përshkrimi i mbeturinës sipas Katalogut Evropian	Kushtet për Administrimin e mbeturinave, magazinimi, mbledhja, grumbullimi, transportimi, trajtimin, deponimin sipas dispozitave të Ligjit për mbeturina.	Dokumenti përkatës
---	--	---------------------------

të Mbeturinave		
01 03 99 - Skoria e FE 01 03 99 -Skoria e konvertorve 10 02 14-Lymi i skruherit 10 02 06- Material zjarrrdruues 12 01 01-Metali nga Tornim 12 01 02-Gypat për fryrje 15 0 04-Bure (fuqi) të dëmtuara(Fabrika +Miniera e Çikatoves) 17 04 05-Llamarin dhe metal tjetër (PQ+Energjetika 13 01 07*-Vaji hidraulik((Mirmbajtja) 13 02 03*-Vaji i përdorur (Mirmb+Transporti i mbrendshëm) 15 01 02-Plastika (FE+Energjetika) 20 01 04-Plastika (Laboratori) 15 01 03- Dru nga paletat (Tr. brendshëm + Transporti i brendshëm) 15 01 07-Qelqe nga	Operatori duhet që Administrimin e mbeturinave, magazinimin, mbledhjen, grumbullimin, transportimin, trajtimin dhe deponimin ta bëjë në përputhje me Legjislacionin për mbeturina, duke i marr parasysh edhe kushtet e përcaktuara në këtë leje. Gjatë deponimit të skories të respektohen rregullat që janë të përshkruara në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për deponin e skories në Sukë Operatori duhet ti përdor TMM sipas BREF dokumentit për Menaxhimin apo trajtimin e mbeturinave të skories (si mbeturinë industriale - mesprodukt). Operatori duhet, që gjatë punës së rregullt të fabrikës të siguroj, që përgjegjësit për menaxhimin e mbeturinave, ti ndërmarrin të gjitha masat, me qëllim të zvogëlimit të prodhimit të mbeturinave, sidomos mbeturinave të rrezikshme, duke zvogëluar shfrytëzimin e lëndëve të para dhe aty ku është e mundur të siguron ripërdorimin e tyre dhe riciklimin. Operatori duhet të bëjë mbledhjen e mbeturinave dhe ti ndan veç e veç, në përputhje me nevojat për trajtimin e tyre dhe të mbanë evidencë për sasinë e mbeturinave të gjeneruara brenda ditës, sasinë e mbeturinave të cilat shiten. Nëse Operatori nuk është në gjendje të organizojë largimin e mbeturinave, në bazë të vendit ku krijohen (origjinës) , ato duhet të dorëzojnë kompanisë së lincencuar për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave. Operatori duhet të i deponoj mbeturinat në vendet të cilat janë teknikisht të pajisura, për ruajtje të përkohshme të mbeturinave. Mbeturinat nuk mund të deponohen në hapësira të hapura si dhe në sipërfaqet manipuluese, të cilat nuk janë të destinuara për deponim të mbeturinave. Depoja e mbeturinave duhet të ketë fundamentin (bazën) stabile dhe kompakte me sistemet përkatëse për mbrojtjen nga ndikimet atmosferike, zjarri dhe aksidentet. Gjatë deponimit të mbeturinave të rrezikshme duhet të paketohen në enë të përshtatshme, të bëhet etiketimi i tyre me të dhënat si: indeksi, numri dhe emri, në përputhje me Katalogun Evropian të Mbeturinave, shenjën sipas listës së kategorisë, shenjën sipas listës së komponentëve, e cila e bënë të rrezikshme, karakteristikat fizike të mbeturinës,	

laboratori	sasinë, informacione mbi pronarin e mbeturinave, kualifikimin e personit përgjegjës për të menaxhuar me mbeturina të rrezikshme, si dhe paralajmërimi se në pyetje është substancë e rrezikshme. Deponia e përkohshme për deponimin e mbeturinave të rrezikshme, duhet me qenë fizikisht e siguar, e mbyllur dhe nën përkujdesje të përhershme. Është e ndaluar përzierja e kategorive të ndryshme të mbeturinave të rrezikshme apo përzierja e mbeturinave të rrezikshme me mbeturina jo të rrezikshme.	
16 01 03-Shirita transportues dhe goma(FRr+Obj.Xeh+Min+Tr		
16 06 05*-Akumulatorë (Miniera+Transporti)		
17 07 03- Mbeturina nga konstruktimi (Punëtorja qendrore)	Operatori për transportimin e mbeturinave të rrezikshme, jashtë lokacionit të fabrikës duhet të angazhoj vetëm kompani të licencuara.	
20 01 01-Letër (të gjitha departamentet)	Operatori duhet, që transportin e brendshëm, ngarkimin dhe shkarkimin e mbeturinave, brenda lokacionit, të kryej në atë mënyrë që pamundëson përhapjen dhe shpërndarjen e mbeturinave dhe ndikimet tjera negative në mjedis.	
20 03 01-Mbeturinë komunale		

3.4 ZHURMA

Emisionet e zhurmës nga Impianti i Lejuar, të matura në pikat e specifikuara në tabelë nuk duhet t'i tejkalojnë vlerat e dhëna në tabelën 3.4.

Tabela 3.4

Vlerat e niveleve ekuivalente A të zhurmës LAeq në dB në zonat përkatëse		
Lokacioni i matjes-Zona industriale	Ditën - mbrëmje 65 - 55 dB	Natën 55 dB
	Maksimumi i lejueshëm 70 - 60 dB	Maksimumi i lejueshëm 55 dB
Lokacioni i matjes - Zona për vendbanim (urbane)	Ditë – mbrëmje 60 - 50	Natën 45
	Maksimumi i lejueshëm, 65-55 dB	Maksimumi i lejueshëm, 50 dB

- Vlerat e rekomanduara të zhurmës (VR) në Db në zonën industriale- Zona për vendbanim (urbane)
- VRp(Vlera e rekomanduar e pranueshme)
- Vmax(Vlera e rekomanduar maksimale)
- Nivelet e lejuara të zhurmës janë përcaktuar në bazë të kriterëve të rekomanduara të nivelit të zhurmës sipas BE-s, Direktiva 2002/49.

Në pajtim me kushtet e kësaj Leje, Operatori duhet, t'i zvogëlojë emisionet e zhurmës siç përshkruhet në Tabelën 3.5.

Tabela 3.5.

Pajisja, artikulli	Kushtet specifike	Dokumenti përkatës
Makineritë transportuese Ventilatori i sistemit të pastrimit të gazrave në konvertor Kompresori i stacionit për trajtimin e ujërave të zeza Ventilatori i precipitatorëve elektrostatik të furrave rrotulluese, gjatë punës së fabrikës.	Detyrohet operatori të kontrollojë procesin e punës në atë mënyrë që të mundësojë që niveli i zhurmës në mjedis në kufijtë e fabrikës (brenda zonës industriale), zonës për vendbanim (urbane) mos të kalon vlerat kufitare të specifikuara në tabelën 3.4. Në rast të tejkalimit të vlerave kufitare të zhurmës operatori duhet merr masat për minimizimin e emitimit të zhurmës. Vendosja e murit të betonuar (nga materiali me veti të mira absorbuese), barrierave natyrore (muri i gjelbërt), etj Futja e pajisjeve (amortizuesit e zhurmës) në instalime, etj)	

4. PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT

Operatori duhet t'i përmbushë kërkesat e specifikuara në Tabelën 4. deri në datën e specifikuar po në të njëjtën Tabelë, si dhe duhet t'ia dërgojë një njoftim me shkrim MMPH për secilën ndërhyrje të kryer (duke e shënuar datën e kryerjes së ndërhyrjes përkatëse), brenda katërmëdhjetë [14] ditësh nga data e përmbushjes së këtyre kërkesave. Për ato kërkesa periudha e realizimit të të cilave është më e gjatë se një vit, raportet me shkrim, mbi progresin e tyre, duhet të dorëzohen MMPH, çdo vit.

Tabela 4.

Aktiviteti	Rezultati i aktivitetit	I realizuar	Afati i fundit
Lokacioni i deponisë për materje të përkohshme	Përmirësimi i administrimit dhe riciklimi i mbeturinave	2012	
Skruberi në furrat elektrike F 1 + 2	Përmirësimi i emisionit të ajrit në furrat elektrike 1+2	2010	
ISO 9001	Sistematizimi i punës	2011	

Stacioni monitorues për ajrin ambiental x 2	Monitorimi i cilësisë së ajrit ambiental	2011	
SMKE (Sistemi i Monitorimit Kontinual) në të gjitha emisionet në ajër	Monitorim total i emisioneve në ajër	2012	
ISO 14001	Sistemi për Menaxhimin e Mjedisit	2012	
Vlerësimi i rrezikut	Parandalimi dhe reagimi nga aksidentet dhe funksionimet jostabile të fabrikës		2015
Rinovimi i parë i filtrit (PES) në FRR	Përmirësimi i emisionit në ajër tek furrat rrotulluese.	Mars 2013	
Dhomë shtesë në filtrin 1 të FRR	Përmirësimi i emisionit në ajër tek furrat rrotulluese.	2014	
Përmirësimi i basenit në kullën ftohëse	Rritja e basenit të ujit, parandalimi i shkarkimit. Përmirësim i emisionit të ujit	Dhjetor 2012	
Deponia për vajrat e përdorura	Mbledhje më e mirë e vajit të përdorur	Gusht 2012	
Mbjellja e drunjve nëpër fabrikë	Zvogëlimi i emisioneve fugitive të mundshme		2015
Ri-kultivimi i deponisë së skories + monitorimi	Rehabilitimi deponisë së skories		2017
Një kanal shtesë për ujë në zonën e pranimit të xehes	Do të përmirësoj mbledhjen e ujit dhe përmirësimi i emisionit të ujit	Prill 2014	
Ndarësi i vajit që t'i mbledh rrjedhjet e mundshme të vajit jashtë fabrikës	Përmirësimi i emisionit kryesor të ujit		2015
Raportimi CSR (Përgjegjësia Sociale e Korporatës)	Bashkëpunim më i mirë me komunën dhe shoqëritë		
Baseni sedimentues për ujin nga të reshurat në fabrikë	Përmirësimi i emisionit kryesor të ujit		2015
Dhomë shtesë në PES-in nr. 2 (FRR)	Zvogëlimi i emisionit prej nivelit 100 mg/Nm ³ në 50 mg/Nm ³		Qershor 2016

5. DISPOZITAT TJERA

5.1. EVIDENCA

5.1.1. Operatori duhet të mbajë evidencë për:

a) të gjitha monitorimet dhe marrjet e mostrave, të kryera në pajtim me Planin e Vetmonitorimit që i është bashkëngjitur kësaj leje, si dhe të mbajë evidencë për çdo analizë apo vlerësim të bërë mbi bazën e këtyre të dhënave;

b) çdo keqfunksionim, rënie nga funksionit apo avari të pajisjeve apo stabilimenteve të Impiantit (përfshirë çfarëdo mase riparuese afatshkurta apo afatmesme) që mund të kenë, kanë pasur, apo që mund të kenë pasur ndikim të Impiantit në mjedis.

5.1.2. Të gjitha evidencat e bëra nga Operatori lidhur me operimin e Impiantit, duhet të vihen në dispozicion për inspektim nga MMPH-ja, në çfarëdo kohe.

Me kërkesën e MMPH-së një kopje e cilës do evidencë që kërkohet, duhet të dorëzohet nga Operatori.

Këto evidenca duhet:

a) të jenë qartë të lexueshme;

b) të paraqesin çdo ndryshim të bërë, si dhe duhet të përmbajnë edhe versionin origjinal të tyre.

5.1.3. Evidencat duhet të ruhen për një periudhë prej pesë (5) vitesh nga data e shënimit të tyre.

5.1.4. Operatori duhet të mbajë evidencë për ankesat e paraqitura në lidhje me ndikimet negative në mjedis. Evidenca, e mbajtur, në formën e regjistrit, duhet të përmbajë datën e ankesës, një përmbledhje të çfarëdo hetimi të bërë mbi bazën e atyre ankesave, si dhe duhet të përmbajë rezultatet e atij hetimi.

5.2. RAPORTIMI DHE NJOFTIMET

Raportimi

5.2.1. Të gjitha raportet dhe njoftimet që kërkohen me këtë Leje, duhet të dërgohen në MMPH, në adresën e specifikuar në Parathënien e kësaj Leje.

Njoftimet

5.2.2. Operatori duhet ta njoftojë MMPH-në, pa u vonuar, për:

a) detektimin e çfarëdo emisioni të cilësdo substancë e cila e tejkalon vlerën kufitare apo kriteret e specifikuar në këtë Leje;

b) detektimin e çfarëdo keqfunksionimi, rënies nga funksioni apo avarie të pajisjeve apo stabilimenteve që ka shkaktuar apo që ka potencial të shkaktojë ndotje;

5.2.3. Operatori duhet të dorëzojë një vërtetim me shkrim tek MMPH, për çfarëdo njoftimi të bërë në pajtim me kushtet e kësaj Leje, duke i dërguar të dhënat e mëposhtme, 24 orë pas dërgimit të njoftimit:

a) emrin e Operatorit;

b) numrin e Lejes;

c) lokacionin e Impiantit;

d) kohën, datën, dhe lokacionin e emisionit/ shkarkimit të substancave ndotëse;

e) sasisë emisionit si dhe kohën, gjatë së cilës ka ndodhur emisioni.

f) lokacionin ku ka ndodhur emisioni

g) masat e ndërmarra, apo masat që synohet të ndërmerren, për të ndaluar emisionin

Jo më vonë se 28 ditë, prej ditës së dorëzimit të njoftimit të incidentit, MMPH-së duhet t'i dorëzohen me shkrim të dhënat shtesë, të renditura më poshtë:

h) të dhëna të tjera, për çështjet e njoftuara në vërtetimin origjinal të dorëzuar me shkrim;

i) masat e ndërmarra, apo masat që synohet të ndërmerren, për të parandaluar rishfaqjen e incidentit;

j) masat e ndërmarra, apo masat që synohet të ndërmerren, për të korrigjuar, kufizuar apo parandaluar çfarëdo ndotje apo dëmtim të mjedisit, që është shkaktuar apo që mund të shkaktohet nga emisioni; dhe

k) raport për incidentet, brenda 24 muajve të kaluar.

5.2.4. Operatori duhet t'i dorëzojë një njoftim me shkrim MMPH, për veprimet e mëposhtme, në rast të:

a) ndërprerjes së punës së ndonjë stabilimenti të Impiantit;

b) ndërprerjes së punës së ndonjë stabilimenti të Impiantit, për një periudhë që ka mundësi të zgjasë më shumë se 6 muaj; dhe

c) ristartimit të operimit të cilësdo pjesë apo të tërë Impiantit, pas një ndërprerjeje në pajtim me pikën b).

5.2.5. Operatori duhet ta njoftojë me shkrim MMPH, brenda 14 ditësh për çështjet në vijim:

a) çfarëdo ndryshimi i emrit apo adresës së Operatorit;

b) kur Operatori paraqet një person apo një grup personash, në rastin e vdekjes së ndonjërit prej tyre;

c) në rastin e shpërbërjes apo ndryshimit të pronësisë së saj apo të statusit (duke përfshirë kontratën e qirasë);

5.2.6. Operatori duhet ta njoftojë me shkrim MMPH, brenda 14 ditësh, prej shfaqjes së çfarëdo ndryshimi të lejeve, licencave, autorizimeve apo marrëveshjeve tjera rregulluese, të cilat mund të jenë relevante për kushtet e kësaj Leje.

5.3 VLEFSHMËRIA DHE DISPOZITAT PËR NDRYSHIM

5.3.1. Kjo Leje hynë në fuqi më: _____ e vlefshme deri më: _____

5.3.2. Operatori duhet të aplikojë për vazhdimin e kësaj Leje së paku 60 ditë, para datës së skadimit të saj.

5.3.3. Operatori duhet të aplikojë për ndryshim të kësaj Leje në rast se Operatori planifikon një *ndryshim të qenësishëm në operim*. Operatori duhet të përdorë Formën Standarde të Aplikacionit për Leje Mjedisore të Integruar dhe ta plotësojë atë, duke përfshirë cilindo ndryshim të bërë në krahasim me aplikacionin origjinal të lejes, përfshirë.

Pas procedurës standarde të aplikimit për ndryshim të operimit, MMPH lëshon vendimin për ndryshimin e Lejes.

5.3.4. Kur ndryshimi i paraparë në operim nuk ka gjasë të kërkojë ndryshimin e kushteve të lejes, Operatori duhet të kërkojë një marrëveshje me shkrim nga MMPH, në mënyrën e poshtë shpjeguar:

a) Operatori duhet t'i dorëzojë MMPH një njoftim me shkrim për detajet e ndryshimit të propozuar, duke e prezantuar pjesën relevante të Lejes. MMPH brenda 30 dite, lëshon Vendimin për ndryshimin e lejes.

b) njoftimi i dorëzuar nga Operatori përfshinë vlerësimin e ndikimeve të mundshme në mjedis, të ndryshimit të propozuar, si dhe arsyetimin që për këtë ndryshim të operimit nuk kërkohet një aplikacion për ndryshim të kësaj Leje.

c) çdo ndryshim i propozuar nga Operatori përmes njoftimit, nuk duhet të zbatohet deri në nënshkrimin e marrëveshjes me shkrim. Nëse njoftimi i dorëzuar nga Operatori refuzohet nga MMPH, Operatori duhet të dorëzojë aplikacionin për ndryshim.

5.3.5. Nëse Operatori e ndryshon adresën, e cila është e shënuar në Leje, ai duhet ta njoftojë me shkrim MMPH, brenda 5 ditësh, nga data e ndryshimit. Vetëm atëherë kjo Leje mund të konsiderohet e ndryshuar.

5.3.6. MMPH, ruan të drejtën e ndryshimit të kushteve të kësaj Leje, në çdo kohë, me lëshimin e një Njoftimi për Ndryshim.

PËRFUNDIMI

ARSYESHMËRIA

Aplikacioni i operatorit NewCo Ferronikeli me Nr. Protokolit 593/12, i dorëzuar me datë 09.03.2012 në Ministrinë e Mjedisit dhe planifikimit Hapsinor është në përputhje me dispozitat e Ligjit Për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes Nr.03/L-043.si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.03/2011 për Formën,Përmbajtjen dhe Mënyrën e Plotësimit të Aplikacionit për Leje të Integruar.Operatori në aplikacion ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm sipas ligjit Për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes.Operatori e ka paraqit listen e pëlqimeve: Pëlqimi Mjedisor për shkritoren e Newco Ferronikeli Complex LLC,Drenas me Nr.07/1403/1-ZSP-1488 datë të lëshimit 13.07.2007, Pëlqimi Mjedisor për stacionin për prodhimin e Oksigjenit me Nr.09/2084/1-ZSP/10 datë të lëshimit 11.01.2010, Pëlqimi Mjedisor për deponinë e skorjes në Sukë me Nr.10/2591/1-ZSP-106/11 datë të lëshimit 04.05.2011. NewCo Ferronikeli ka plotësuar apliacionin për shkarkimin e ujrave të zeza por ende nuk është paisur me leje,Certifikaten mbi të drejtat e pronës së paluhatshme,Certifikata e regjistrimit të biznesit me të dhënat e

biznesit, kontratën për shfrytëzimin e ujit . Të gjitha informatat e paraqitura në këtë aplikacion, aplikuesi i deklaron, të vërteta, të sakta, të plota dhe janë në dispozicion për publikut, si dhe dëshmi për pagesën e taksës administrative.

Komisioni ka shqyrtuar aplikacionin, ka zhvilluar një sërë takimesh me përfaqësues të NewCo Ferronikeli dhe vizita në Fabrikë.

Pas përgatitjes së draftit të parë është mbajtur **Debati Publik me datën ...** Në përputhje me të dhënat e mësipërme Komisioni vlerëson se operatori NewCo Ferronikeli, ka plotësuar të gjitha kushtet për marrjen e Lejes Mjedisore të Integruar.

Shtojca 1

PLANI PËR VETËMONITORIM

FABRIKA

NewCo Ferronikeli

Aktiviteti në kuadër të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 03/L-043 për “Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes”

1 – ÇËSH TJET MJEDISORE

1.1 – Lëndët e para dhe produktet

Lëndët që përdoren

Tab 1.1.1 – Lëndët e para

Emërtimi	Ruajtja / deponimi	NJ. M	Shpeshtësia
Xehe	Deponim i jashtëm	Ton	Vjetore
Linjit	Deponim i jashtëm	Ton	Vjetore
Qymyrguri	Deponim i jashtëm	Ton	Vjetore
Koks	Deponim i jashtëm	Ton	Vjetore
Masë elektroda	Deponim i jashtëm (në thasë të mëdhenj)	Ton	Vjetore
Guri gëlqeror	Deponim i jashtëm	Ton	Vjetore
Gëlqerja	Deponim brenda (hangar)	Ton	Vjetore

*Referuar tabelës 1 – Përdorimi i lëndëve të para dhe materialeve ndihmëse (aplikacioni i IPPC-së)

Tab 1.1.2 – Lënda ndihmëse

Emërtimi	Ruajtja	NJ. M	Shpeshtësia
Oksigjen (i lëngtë)	Rezervuarë	Kg ose Ton	Vjetore
Oksigjen (gaz)	Impianti i oksigjenit	Kg ose Ton	Vjetore
Materiali zjarrrdurues	Depoja qendrore	Ton	Vjetore

* Referuar tabelës 1

Produktet

Tab 1.1.5 – Produktet finale

Emërtimi	Ruajtja	NJ. M	Shpeshtësia
Ferronikeli	Deponim i jashtëm	Ton	Vjetore

1.2 - Uji

Tab 1.2.1 – Shfrytëzimi i ujit

Lloji i furnizimit	Pika matëse	NJ. M	Shpeshtësia
Proces të prodhimit	Orëmatësi për ujë DN600	m ³	Vjetore
Për nevoja joproduhuese (kuzhinë, etj)	Orëmatësi për ujë DN200	m ³	Vjetore

* Referuar tabelës 10 & 33 – Përdorimi i ujit (aplikacioni i IPPC-së)

1.3 – Burimet energjetike

Tab 1.3.1 – Energjia

Emërtimi	Lloji	Faza e prodhimit	Sistemi matës	NJ. M	Shpeshtësia
Energjia importuar e	Energjia elektrike	Fabrika	Digjital	kWh	Vjetore
Energjia importuar e	Energjia termale				
Termocentral	Prodhimi i energjisë elektrike				

* Referuar tabelës 7 – Përdorimi energjisë elektrike (aplikacioni i IPPC-së)

Tab 1.4.1 – Lëndët djegëse

Emërtimi	Faza e prodhimit	NJ. M	Metoda e matjes	Shpeshtësia
Mazut	Proces të prodhimit	Ton	Matësi i nivelit me sensor	Vjetore
Mazut	Ngrohje	Ton	Matësi i nivelit me sensor	Vjetore
Petkoksi	Proces të prodhimit (brineri/ndezësi i furrës rrotulluese)	Ton	Matësi i nivelit me sensor	Vjetore
Gazi propan -butan	Djegia e gazrave pas skruherit të FE në maje të oxhakut dhe startimin e ndezësit të furrës rrotulluese	Ton	Matësi i nivelit me sensor	Vjetore

* Referuar tabelës 8 & 13 – Shfrytëzimi lëndëve djegëse në energjetikë (aplikacioni i IPPC-së)

1.5 – Shkarkimet në ajër (emisionet)

Tab 1.5.1 – Pikat e shkarkimeve (emisioneve) në ajër

Pikat e shkarkimeve (emisioneve) në ajër	Faza e prodhimit	Sistemi i pastrimit	Kohëzgjatja e emisionit (ditë/vit)
A2.1	Furra Rrotulluese	Precipitatorët Elektrostatik (PES)	Kontinuale
A2.2	Konvertori	Skruberi me ujë	Ciklike (me faza)
A2.3	Furra elektrike 1	Skruberi me ujë	Kontinuale
A2.4	Furra elektrike 2	Skruberi me ujë	Kontinuale
A1.1	Ngrohtorja	-	Periodike

* Referuar tabelës 11 & 15 – Emisionet në ajër dhe kontrolli i tyre si dhe karakteristikat (aplikacioni i IPPC-së)

Tab 1.5.2 – Ndotësit

**Laboratori i licencuar dhe i pavarur “TEHNOLAB” nga Shkupi.

Pika e emisionit	Substanca	NJ. M	Shpeshtësia**	Metoda e matjes
A2.1	Pluhuri	mg/Nm ³	1/muaj	MKS ISO 9096:2008
	Monoksidi i karbonit	mg/Nm ³	1/muaj	MKS ISO 12039:2008
	Dyoksidi i sulfurit	mg/N	1/muaj	MKS ISO 7935:2008
	Oksidet e azotit	mg/Nm ³	1/muaj	MKS ISO 10849:2008
	Dyoksidi i karbonit	%	1/muaj	MKS ISO 12039:2008
A2.2	Pluhuri	mg/Nm ³	1/muaj	MKS ISO 9096:2008
	Monoksidi i karbonit	mg/Nm ³	1/muaj	MKS ISO 12039:2008
	Dyoksidi i sulfurit	mg/Nm ³	1/muaj	MKS ISO 7935:2008
	Oksidet e azotit	mg/Nm ³	1/muaj	MKS ISO 10849:2008
	Dyoksidi i karbonit	%	1/muaj	MKS ISO 12039:2008
A2.3	Pluhuri	mg/Nm ³	1/muaj	MKS ISO 9096:2008
A2.4	Pluhuri	mg/Nm ³	1/muaj	MKS ISO 9096:2008
A1.1	Monoksidi i karbonit	mg/Nm ³	1/muaj	MKS ISO 12039:2008
	Dyoksidi i sulfurit	mg/Nm ³	1/muaj	MKS ISO 7935:2008
	Oksidet e azotit	mg/Nm ³	1/muaj	MKS ISO 10849:2008
	Dyoksidi i karbonit	%	1/muaj	MKS ISO 12039:2008

* Referuar tabelës 11 & 19 – Emisionet në ajër dhe kontrolli i tyre (aplikacioni i IPPC-së)

SMKE – Sistemi për Monitorim Kontinual të Emisioneve*

Pika e emisionit	Substanca	NJ.M	Metoda e matjes (metodologjia)*
A2.1	Pluhuri	mg/Nm ³	Shpërndarje – optike
	Monoksidi i karbonit	mg/Nm ³	IR (rreze infra të kuqe)
	Dyoksidi i sulfurit	mg/Nm ³	IR (rreze infra të kuqe)
	Oksidet e azotit	mg/Nm ³	IR (rreze infra të kuqe)
A2.2	Pluhuri	mg/Nm ³	Shpërndarje – optike
	Monoksidi i karbonit	mg/Nm ³	IR (rreze infra të kuqe)
	Dyoksidi i sulfurit	mg/Nm ³	IR (rreze infra të kuqe)
	Oksidet e azotit	mg/Nm ³	IR (rreze infra të kuqe)
A2.3	Pluhuri	mg/Nm ³	Shpërndarje – optike
A2.4	Pluhuri	mg/Nm ³	Shpërndarje – optike

*Të gjitha metodat e përdorura për SMKE janë sipas metodologjive referente që përdoren në BE.

* Kalibrimi i paisjeve për matje duhet të bëhet duke u bazuar ne ISO14181 2005

Tab 1.5.3 – Metalet e rënda dhe dioksinat

Substanca	NJ.M	Shpeshtësia	Metoda e matjes
Metalet e rënda	mg/Nm ³	1/vit	Indirekte (marrje e mostrës nga tymtari dhe pastaj
Dioksinat	ng/Nm ³	Çdo 2 vite	Indirekte (marrje e mostrës nga tymtari dhe pastaj analizim

1.5.4 – Imisionet (matje kontinuale)

Përcjellja e imisioneve (cilësisë së ajrit ambiental) bëhet me përdorimin e instrumentit 'Airpointer' (2 të tilla në lokacione të ndryshme)

Instrumenti	Substanca	NJ.M	Metoda e matjes (metodologjia)*
Airpointer	PM10 / PM2.5	µg/m ³	UV Fluorescente (EN 14212)
	Dyoksidi i sulfurit – SO ₂	µg/m ³	Nefelometri

1.6 – Emisionet në ujë

Tab 1.6.1 – Pikat e emisionit (shkarkimit)

Pika e emisionit	Faza e prodhimit	Receptori (sistem i ujërave të zeza, trup uhor)	Impianti i trajtimit	Kohëzgjatja e emisionit (ditë/vit)
Gypi shkarkues i fabrikës (SW2 – në hartë)	Fabrika	Trup uhor (lumi Drenica)	Impianti për trajtimin e ujërave të zeza	Kontinuale
Kanali i hapur nga deponia e Sukës (SW5 – në hartë)	Deponia e skories në Sukë	Trup uhor (lumi Drenica)	-	Kontinuale

* Referuar tabelës 22 – Shkarkimi dhe kontrollimi i ujërave të ndotura

Tab 1.6.2 - Ndotësit

Pika e emisionit	Substanca	NJ. M	Shpeshtësia	Metoda e matjes
Gypi shkarkues i fabrikës	TSS, Fe, Ni, Co, Cr	mg/l	Mujore**	TSS-filtrim; metalet e rënda - SAA
	Fiziko - kimik ; mikrobiologjik	mg/l	4 / vit (INKOS)	Të shikohet tabela në shtojcë
Kanali i hapur nga deponia e Sukës	TSS, Fe, Ni, Co, Cr	mg/l	Mujore	TSS-filtrim; metalet e rënda – SAA
	Fiziko - kimik ; mikrobiologjik	mg/l	4 / vit (INKOS)	Të shikohet tabela në shtojcë

* Referuar tabelës 29

**Laboratori jonë i brendshëm përcakton: pH, T, Përçueshmërinë, TDS, TSS, Fe, Ni, Co dhe Cr (pH, T, κ dhe TDS maten me instrument portabël në vend – aty për aty).

1.7 – Zhurma

Tab 1.7.1 – Zhurma

Pozita e pikës matëse (1)	Receptori	Parametri	Shpeshtësia
Zhurma nga automjetet transportuese		Zhurma (dB)	1 /vite
Ventilatori i sistemit të pastrimit të Konvertori		Zhurma (dB)	1 /vite
Kompresori i stacionit për trajtimin e ujërave të zeza		Zhurma (dB)	1/ vite
Ventilatori i PES		Zhurma (dB)	1 /vite
Stacioni kryesor i energjisë elektrike		Zhurma (dB)	1 /vite

(1) referuar pikave matëse në hartë ("Zhurma" – dokumenti i dërguar në MMPH më 17/07/2012)

1.8 - Mbeturinat

Tab 1.8.1 – Mbeturinat e trajtuara

Emërtimi/lloji	KEM kodi	Lloji i ruajtjes	Faza e prodhimit	Analizat dhe lloji i kontrollimit	Shpeshtësia
				pesha (t/vit)	
				Karakteristikat/analizat	
Skoria e konvertorit	01 03 99	Deponim i jashtëm	Konvertori	pesha (t/vit)	Vjetore
				Karakteristikat/analizat	Po
Llumi nga sistemi i pastrimit (skruberit)	10 02 14	Deponim i jashtëm	Sistemi i pastrimit të pluhurit dhe gazrave në FE dhe Konvertor	pesha (t/vit)	Vjetore
				Karakteristikat/analizat	Po

* Referuar tabelës 35 – Administrimi i mbeturinave (“Mbeturinat” dërguar në MMPH më 06/07/12 & 30/08/2012)

Tab 1.8.2 – Mbeturinat e prodhuara

Emërtimi/lloji	KEM kodi	Lloji i ruajtjes	Deponimi (kodi)	Përpunimi (kodi)	Analizat dhe lloji kontrollimit	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia
			D.	R.	pesha (t/vit)		
					Karakteristikat/analizat		
Skoria e FE	01 03 99	Deponim i jashtëm	D1	R13			Vjetore
Skoria e konvertorit	01 03 99	Deponim i jashtëm	D1	R5			Vjetore
Mat. zjarrduruese të përdorura	10 12 07	Deponim i jashtëm	D15	R13			Vjetore
Llumi nga sistemet e pastrimit	10 02 14	Deponim i brendshëm (brenda objektit të llumit)	D15	R5			Vjetore
Ashklat e metalit (tornimi)	12 01 01	Deponim i jashtëm	D15	R13			Vjetore
Gypat e shpenzuar për fryrje	12 01 02	Deponim i jashtëm	D15	R13			Vjetore
Bure të dëmtuara metalike	15 01 04	Deponim i jashtëm	D15	R13			Vjetore
Llamarinë	17 04 05	Deponim i jashtëm	D15	R13			Vjetore
Vaj hidraulik i përdorur	13 01 07*	Deponim i jashtëm (rezervuarë plastik në deponinë e përkohshme për materie të rrezikshme)	D15	R13			Vjetore
Vaj i përdorur	13 02 03*	Si më lart	D15	R13			Vjetore
Rezervuar plastike	15 01 02	Deponim i jashtëm (deponia për materje të perkohshme)	D15	R13			Vjetore
Dru (paleta)	15 01 03	Deponim i jashtëm	D15	R13			Vjetore
Qelqe laboratorike	15 01 07	Kontejner		R13			Vjetore
Shiritat transportues dhe gomat e përdorura	16 01 03	Deponim i jashtëm	D15	R13			Vjetore
Akumulatorët	16 06 05*	Deponim i brendshëm	D15	R13			Vjetore
Mbeturinat nga konstruktimi	17 07 03	Deponim i jashtëm	D15	R13			Vjetore
Letër	20 01 01	Kontejner		R13			Vjetore
Mbeturina	20 03 01	Kontejner		R13			Vjetore

komunale							
----------	--	--	--	--	--	--	--

**Administrimi i mbeturinave (dokument i dërguar në MMPH më 06/07/12 & 30/08/2012)*

1.9 – Toka dhe uji nëntokësor

Tab 1.9.1 – Uji nëntokësor

Pika matëse/piezometri (1)	Ndotësi	NJ. M	Shpeshtësia
GW1	TSS, Fe, Ni, Co, Cr	mg/l	4 herë në vit (Sezonale)
GW2	TSS, Fe, Ni, Co, Cr	mg/l	4 herë në vit (Sezonale)
GW3	TSS, Fe, Ni, Co, Cr	mg/l	4 herë në vit (Sezonale)

(1) referuar hartës

2 - ADMINISTRIMI

2.1 – Kontrollimi fazave kritike, mirëmbajtja, ruajtja

Tab 2.1.1 – Kontrollimi fazave kritike të procesit

Faza e prodhimit	Aktiviteti kontrollues	Parametri që matet	NJ. M	Dokumenti referues	Shpeshtësia
Oxhaku emergjent në FE	Valvula mbyllëse/hapëse	Kontrollimi i pozitës së valvulës	%	Libri i operatorit	Vjetore
	Gazrat	Temperatura e gazrave dalëse	°C	Libri i operatorit	Vjetore
Mbishtypja në FE	Mbishtypja e	Presioni në FEF	Pa	Libri i operatorit	Vjetore

Tab 2.1.2 – Mirëmbajtja e planifikuar për pajisjet për pastrim

PAJISJA	Lloji i intervenimit	Shpeshtësia
Sistemi i skruherit në FE	Mirëmbajtje rregullt e këtyre pajisjeve për pastrim sipas procedurës sonë ISO 9001 FNK-Q-101.02/Rev01	Vjetore
Sistemi i skruherit në konvertor		Vjetore
PES-ët në FRr		Vjetore

Tab 2.1.3 – Kontrollimi i pajisjeve për pastrim

Pika e emisionit	Pajisja për pastrim	Parametrat që kontrollohen	NJ. M	Shpeshtësia
A2.1	PES	T (hyrje dhe dalje)	°C	1 h / vit
		O ₂	%	1 h / vit
		CO	%	1 h / vit
A2.2	Skruberi me ujë	Sasia e ujit (në të dy shkallët)	m ³ /h	1 h / vit
		Presioni	bar	1 h / vit
A2.3 & A2.4	Skruberi me ujë	Presioni në FE	Pa	1 h / vit
		Temperatura e gazrave në dalje të skruherit	°C	1 h / vit
		Presioni gazit në sistem	mmHg	1 h / vit
		Analizat e gazit në dalje të skruherit(CO; CO ₂ ; H; O ₂)	%	1 h / vit
		Sasia e ujit në shkallë të ndryshme	m ³ /h	1 h / vit
		Presioni i ujit në sistem	Pa	1 h / vit

Tab 2.1.4- Kontrollimi i pajisjes për trajtimin e ujërave të zeza

Pika shkarkuese	Pajisja trajtuese	Parametri kontrollohet	NJ. M	Shpeshtësia
Gypi shkarkues i fabrikës (SW2)	Impianti për trajtimin e ujërave të zeza	Dozimi i klorit (Cl)	g/m ³	Kontinuale/vjetore

Tab 2.1.5 - Deponimet (kazanët, rezervuarët, basenet,...)

Përshkrimi	Parametrat që kontrollohen	Lloji i kontrollit	Shpeshtësia
Rezervuarët kryesorë për ruajtje të mazutit (2 x 400 m ³)	Kontrollim vizual (inspektim) Niveli (%), temperatura (°C)	Sistem automatik	Vjetore
Rezervuarët ditor për ruajtje të mazutit për FRr (2 x 40 m ³)			
Rezervuari për ruajtje të mazutit për tharëse (75 m ³)			
Rezervuari për ruajtje të mazutit për ngrohtore (500 m ³)			

Tab 2.1.6 – Emisionet jo të vazhdueshme në ajër

Aktiviteti	Substanca	Veprimi parandalues	Lloji i kontrollimit	Shpeshtësia
Oxhaku emergjent në FE	Pluhur dhe gazra	Kontrollimi i mbipresionit në FE	Automatik dhe manual	Vjetore
Rrugët e brendshme	Pluhur	Pastrimi dhe spërkatja e rrugëve me ujë (veçanërisht gjatë motit të thatë – 2 herë në muaj)	Inspektim	Vjetore

Parametrat dhe metodat që përdoren nga Instituti INKOS janë paraqitur në tabelën vijuese. Shpeshtësia e matjeve (dinamika) është çdo 3 muaj (sezonale).

Nr.	Parametri (mg/l)	Pajisjet për matje ose metodat e përdorura	Standardi
1	Koha e mostrimit [h]	-	-
2	Era	Numri kufi:TON / TFN	SSH EN 1622 : 2002
3	Ngjyra	Kontrolli dhe përcaktimi i ngjyrës	SSH EN ISO 7887:2002
4	Temperatura most.[°C]	Termometër digjital & zhive	SSH EN ISO 2639 -5:1989
5	Turbullira [NTU]	Turbidimetri HACH/RATIO XR	SSH EN ISO 7027:2001
6	Vlera pH	pH-metër METTLER TOLEDO	ISO 10523:2000
7	Përçuesh. ele.[μS/cm]	Konduktometer (HACH sension 7)	SSH EN 27888:2001
8	Harxhimi i KMnO ₄	Vëllimetri: Përcaktimi i treguesit të permanganatit	EN ISO 8467:2002
9	O ₂ i tretur	Metoda me sensor elektrokimik (Oksigjenometer HACH sension 8)	SSH EN ISO 25814:2003
10	Kloruret	Vëllimetri- (Metoda e Mohrit)	SSH ISO 9297:2000
11	SHBO ₅	Oksigjenometer HACH sension 8	SSH EN ISO 25814:2003
12	Vlera "p"[mval/l]	Vëllimetri, Përcaktimi i alkalitetit të përgjithshëm dhe alkalitetit karbonat	S SH EN ISO 9963-1 :1999 9963-2 :1999
13	Vlera "m"[mval/l]		
14	Amoniaku	Metoda spektrometrike	ISO 7150-5:1986
15	Joni amonium	Metoda spektrometrike	ISO 7150-5:1986
16	Nitratet , NO ₃ -N	Metoda spektrometrike	ISO 7890: 2000
17	Nitritet NO ₂ -N	Metoda spektrometrike	SSH 2639-1989:
18	Sulfatet	Metoda spektrometrike	SSH ISO 9280:2000
19	Fosfatet	Metoda spektrometrike	ISO 6878:2004
20	Materiet e suspenduara	Metoda spektrometrike	SSH ISO 2639-21:1989

Analizat mikrobiologjike

Nr.	Parametri (CFU/100 ml)	Metodologjia	Vërejtje (standard)
-----	------------------------	--------------	---------------------

1	<i>Enterococci</i>	Membranë filtri; mbjellja në baza ushqyese;	
2	<i>Escherichia coli</i>	Membranë filtri; 3M TM Petrifilm TM	
3	Bakteret <i>Totale coliforme</i>	Membranë filtri; 3M TM Petrifilm TM	
4	<i>Clostridium</i>	Membranë filtri; mbjellja në baza ushqyese për llojin <i>Clostridium spp.</i>	

CFU = Coloni Forming Unit (Njësi Formuese e Kolonive)

Metodat e përdorura

1. ISO 9308-1:2003. Water quality. Detection and enumeration of *Escherichia coli* and coliform bacteria. Part 1: Membrane filtration method (ISO 9308-1:2000)
2. USEPA. Method 1103.1: *Escherichia coli* (*E. coli*) and *Total coliforme* in Water by Membrane Filtration Using membrane-Thermotolerant *Escherichiacoli* Agar (mTEC)
3. USEPA. Method 1106.1: Enterococci in Water by Membrane Filtration Using membrane-Enterococcus-Esculin Iron Agar (mE-EIA)
4. Ohio water microbiology laboratory analysis of *Clostridium perfringens* in environmental water samples.